UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU
Kabineti I Ministrit	Office of the Minister	Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV
NUMËR 50/04
DATA.30.08.2004

LËNDA: Udhëzim administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve.

Në bazë të nenit 42.1. të Ligjit nr 2002/02 mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, dhe neni 1.3 pika (ç) Shtojca IV pika (v), (vi) të Rregullores së UNMIK –ut nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (më tutje MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1
Qëllimi

1.1. Me anë të këtij Udhëzimi administrativ caktohen parimet themelore të Sistemit të Ri të Vlerësimit, llojet dhe procedurat e vlerësimit të shkallës së arritshmërisë së nxënësve, mjetet për matje dhe vlerësim si dhe notimi i shkallës së arritshmërisë së nxënësve.

1.2. Standardizimi i procesit të vlerësimit është në funksion të mësimnxënies dhe ofron lehtsim për të gjithë pjesëmarrsit që marrin pjesë në këtë proces.

1.3. Vlerësimi i nxënësve duhët që të :
- rrespektojë personalitetin e nxënësit,
- ta nxisë vetbesimin e nxënësit dhe ndjenjen për përparim,
- ta nxisë nxënësin të verifikojë dijën e tij,
- aftësonë nxënësin për mësim të pavarur për vetëvlerësim dhe vlerësim të tjerve

- **1.4.** Përcaktimi i kritereve dhe metodave themelore në procesin e vlerësimit.

Neni 2
Rregulla të përgjithshme

2.1. Procesi i vlerësimit është i lidhur ngushtë me të kuptuarit e termave si :

a. **Qëllimi**; tregon cakun përfundimtar të një lloj vlerësimi, rezultati përfundimtar që parashtrohet për t`u arritur me llojin e caktuar të vlerësimit.
b. **Objektivat**; janë rezultate të të nxënit që do të duhej t`i reflektojnë mësimëdhënësit atë çka nxënësi do të duhej të njoh, kuptoj dhe është në gjendje të bëjë e jo çka mësimdhënësi do të duhej të demonstrojë.
c. **Përmbajtja**; është tërësia e përmbajtjeve programore që përfaqësojnë faktet, konceptet, parimet dhe dukuritë qëndrore të lëndës apo fushës programore.
d. **Kontrolli**; është proces i mbledhjes së informatave rreth aftësive të nxënësve.
e. **Testi**; është instrument i matjes, i përbërë nga një seri kërkesash, ushtrimesh apo detyrash të tjera, për të matur shkallën e arritshmërisë së aftësive, shprehive dhe njohurive të nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor.
f. **Testimi**; është një procedurë, përmes së cilës merren të dhënat për shkallën e nxënies së nxënësve duke përdorur lloje të ndryshme të testeve.
g. **Matja**; është proces i krahasimit të dy madhësive, proces i përshkrimit numerik të shkallës së fituar për karakteristikat e pjesëshme që disponon një individ.
h. **Vlerësimi**; është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzuese.
   - **Vlerësimi klasifikues;** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotëruara paraprake dhe në raport me objektivat e parashikuara.
   - **Vlerësimi formues;** ka për qëllim të kontrollojë përparimin e nxënies së nxënësve gjatë procesit mësimor, pra kontrollon shkallën e zotërimit të objektivave udhëzues.
   - **Vlerësimi diagnostifikues;** ka për qëllim që të përcaktojë shkaqet e qëndrueshme të problemeve në mësimnxënie dhe formulimin e planit për veprim për ndihmë nxënësve.
   - **Vlerësimi përmbledhës;** ka për qëllim notimin dhe certifikimin e nxënësve, gjithashtu siguron informata për të gjykuar përvetësimin e objektivave të lëndës (modulit) dhe efektshmërisë së programit mësimor.
   - **Vetëvlerësimi**; është proces i grumbullimit të informatave që ka për qëllim të përcaktojë vetë nxënësi, se në çfarë shkalle i zotëron objektivat udhëzuese.
i. **Vlefshmëria e testit;** një test është i vlefshëm nëse arrin të matë atë që ne kemi synuar ta masim.
j. **Qëndrueshmëria e matjes;** na tregon se sa janë të qëndrueshme pikat e një testi, apo rezultatet tjera të vlerësimit, nga një matje në tjetrën.
k. **Besueshmëria;** tregon se sa një instrument është i besueshëm gjatë procesit të matjeve të së njejtës gjë apo karakteristike, pra na siguron besimin e rezultateve tona në matje dhe vlerësim.
l. **Kërkesa;** është "njësië e matjes me një formë stimuluese dhe përshkruese për përgjigjje; ajo kërkon nga nxënësi një përgjigjje nga e cila nxirret një përfundim për dituritë, aftësitë, predispozitat apo tiparet e tij".
m. **Llojet e testeve;** testi i bazuar në normë (i rangimit), testi i bazuar në kriter (i zotërimit), testi i bazuar në objektiva (diagnostikues), testi përmbledhës (i arritshmërisë, i kombinuar), testi i pastandardizuar, testi i standardizuar, testi

objektiv, testi subjektiv, testi i bazuar në sjellje.

Neni 3
Parimet themelore

Secili mësimdhënës ose vlerësues i brendshëm apo i jashtëm, është i obliguar t`i respektojë këto parime themelore gjatë procesit të vlerësimit.

3.1. Përcaktimi i qëllimit dhe përparësitë e llojit të vlerësimit;

- Përshkrimi i kujdesshëm i qëllimit të matjes;
- Rezultatet e parashikuara të të nxënit;
- Zgjedhja e matjeve të mundshme.

3.2. Zgjedhja e teknikave të përshtatshme të vlerësimit në përputhje me karakteristkat që duhen të maten

- Objektive;
- Të sakta;
- Të përshtatshme.

3.3. Zbatimi i teknikave të ndryshme të vlerësimit

- **Vrojtimi**; që të vlerësojë shkathtësitë e manifestimit dhe sjelljet e ndryshme të nxënësit;
- **Teste objektive**; kur vlerësuesit e ndryshëm që i masin të njejtat objektiva në mënyrë të pavarur arrinjë rezultate të njejta të shkallës së arritshmërisë.
- **Testi subjektiv**; kur vlerësohet në bazë të kritereve dhe gjykimit të vlerësuesit;
- **Teste ese;** që t`i masim aftësitë për organizimin dhe shprehjen e ideve;
- **Vetëraportimi**; vlerësohen shkathtësitë e nxënësit me hulumtime të ndryeshme , nxjerrja e përfundimeve dhe raportimi i tyre;
- **Portofolio (dsja):** përzgjedhja e punimeve më të mira nga vetë nxënësi, por edhe nga mësimëdhënësi apo nxënësit e klasës apo prindërit.
- **Pyetësori**;

3.4. Dobësitë e teknikave të vlerësimit

- Gabimi gjatë matjes; problem i rëndomtë në matjet arsimore dhe psikologjike;
- Gabimi i pikëzimit të testit (sipas rastit);
- Interpretimi jo i saktë i rezultateve të matjes;

3.5. Vlerësimi është një rrugë drejt një fundi, por jo fund në vetvete.

- Eliminimi i gabimeve të matjes
- Marrja e vendimit për cilësinë e dhënë nuk shënon fundin
- Procesi i vlerësimit zhvillohet në mënyrë të përsëritshme

Neni 4
Matja

4.1. Procesi i vlerësimit gjithëherë është i lidhur ngushtë me mbledhjen e informatave të sakta dhe të bollshme.

4.2. Procesi i mbledhjes së informatave është i lidhur ngushtë me procesin e matjes, ndërsa matja bëhet duke përdorur lloje të ndryshme të instrumenteve, varësisht se çfarë dëshirojmë të masim (shih nenin 3.3).

Neni 5
Mjetet (instrumentet) për matje

5.1. Është shumë me rëndësi që mësimdhënësi gjatë procesit të matjës dhe në përputhje me qëllimin e vlerësimit të përdorë mjetin (instrumentin) më efikas për mbledhjën (marrjën) e informatave të mjaftueshme, para se të sjellë vendimin për shkallën e arritshmërisë së të nxënit.

5.2. Gjatë procesit të vlerësimit në klasë, mësimdhënësi është i obliguar të përdorë të gjitha llojet e instrumenteve përkatëse për matje në përputhje me qëllimin dhe objektivat e vlerësimit.

5.3. Është i palejueshëm përdorimi i vetëm një mjeti të matjes, sikur që nuk lejohet zëvendësimi i një mjeti me mjetin tjetër të matjes, nga se me një lloj të mjetit mund të maten vetëm rezultate të caktuara të të nxënit.

5.4. Mjetet kryesore të matjes, janë:

a. Vrojtimi
b. Testi me gojë
c. Testi me shkrim
d. Vetëraportimi
e. Pyetësori
f. Portofolio (dosja)
g. Fleta kontrolluese

5.5. Mësimdhënësi duhet të aftësohet se si t`a zhvillojë tërë procedurën e zhvillimit dhe administrimit të mjetit të cakuar të matjes dhe të nxjerrë vendim për shkallën e arritshmërisë të të nxënit (përfitimit).

Neni 6
Përcaktimi i objektivave

6.1. Secila shkollë (drejtor i shkollës dhe Këshilli i mësimdhënësve) është i obliguar që t`i përcaktojë objektivat e matshëm të arritshmërisë së nxënësve, para fillimit të vitit mësimor në përputhje me objektivat kombëtare, të përcaktuara në planprogram të lëndës.

6.2. Gjithashtu edhe secili aktiv profesional i lëndës përkatëse i cakton objektivat e matshme të arritshmërisë në përputhje me objektivat e shkollës.

6.3. Objektivat duhen të jenë në përputhje me rezultatet e arritshmërisë së të nxënit të një shkolle dhe të një lënde mësimore, respektivisht të një aktivi profesional apo fushë lëndore.

Neni 7
Matja e rezultateve të të nxënit

7.1. Secili mësimdhënës duhet të zhvillojë mjetin përkatës për matjen e rezultateve të të nxënit në përputhje me qëllimin e vlerësimit.

7.2. Është shumë me rëndësi për secilin mësimdhënës që të ketë shkathtësitë e duhura profesionale për vlerësim, që në përputhje me qëllimin e matjes dhe të vlerësimit të përdorë mjetin e përshtatshëm të matjes, përndryshe matja është e pavlefshme.

7.3. Gjatë procesit të matjes, mësimdhënësi duhet që në përputhje me qëllimin e matjes dhe vlerësimit t`i përdorë të gjitha mjetet e ndryshme të matjes në mënyrë që vlerësimi të ketë informata sa më relevante dhe objektive për shkallën e arritshmërisë së të nxënit të nxënësve.

7.4. Mësimdhënësi duhet të ketë parasysh gjithmonë gabimet e mundshme gjatë procesit të matjes.

7.5. Që gabimet të jenë sa më të vogla gjatë procesit të matjes, mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë metoda dhe mjete të matjes.

Neni 8
Llojet e vlerësimit

8.1. Në përputhje me metodologjitë e reja të mësimëdhënies dhe mësimnxënies, duhet zbatuar lloje të ndryshme të vlerësimit në mënyrë që të sigurohen informata të mjaftueshme për shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

8.2. Në sistemin e ri të vlerësimit duhet të përdorën këto lloje të vlerësimit:

a. Vlerësimi klasifikues;
b. Vlerësimi formues;
c. Vlerësimi diagnostifikues;
d. Vlerësimi përmbledhës;
e. Vetëvlerësimi.

8.3. Për zbatimin e këtyre llojeve të vlerësimit, duhet të konsultohet literatura përkatëse profesionale dhe të ndiqen trajnime aftësimi, se si dhe kur duhet të zbatohen llojet e ndryshme të vlerësimit, ashtu që mësimëdhënësi t`i ikë mundësisë së kundërefektit të një apo llojit tjetër të vlerësimit, dhe që llojin e caktuar të vlerësimit ta përdorë për qëllimin e duhur të vlerësimit.

8.4. Secili mësimdhënës është i obliguar të pajiset me një çertifikatë me anë të cilës dëshmohet se është i përgatitur për të vlerësuar mësimnxënien dhe shkathtësitë e nxënësit në shkollë.

Neni 9
Vlerësimi i brendshëm

9.1. Secili mësimdhënës është i obliguar që në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, të sigurojë të gjitha llojet e vlerësimit, të cilat me anë të këtij udhëzimi administrativ përcaktohen si të domosdoshme për të sjellë vendim për shkallën e arritshmërisë së nxënësit në klasë në fazat e ndryshme të ndërtimit të tij mendor, shpirtëror dhe fizik.

9.2. Vlerësimi i brendshëm bëhet nga mësimëdhënësi apo nga aktivet profesionale të lëndëve përkatëse, brenda shkollës për qëllime të ndryshme të saj.

9.3. Me këtë lloj vlerësimi, mësimëdhënësi dhe nxënësi e vlerësojnë punën dhe arritjet e rezultateve të tyre në zotërimin e objektivave udhëzues të lëndës mësimore për klasën përkatëse.

Neni 10
Vlerësimi i shkallës së arritshmërisë

10.1. Është e domosdoshme paraprakisht të caktohet nga ana e mësimëdhënsit, se çfarë rezultatesh të të nxënit pritet nga nxënësi të njohë, të kuptojë, të zbatojë apo të nxjerrë mendim kritik në përputhje me standardet e përmbajtjes dhe të arritshmërisë sipas planprogramit së lëndës dhe klasës përkatëse .

10.2. Secili mësimdhënës është i obliguar që në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, të sigurojë vendosjen e kritereve apo kërkesave (shkallën e detyrueshme të treguesëve) të cilat nxënësi duhet t`i demonstrojë me rastin e matjes me anën e instrumenteve të ndryshme të matjes apo në sjelljet e përditshme si : të njohë, të kuptojë, të zbatojë apo të nxjerrë mendim kritik (shih nenin 13.1.).

10.3. Secila shkollë (drejtor i shkollës dhe Këshilli i mësimdhënësve) është e obliguar që t`i përcaktojë statndardet e arritshmërisë së shkollës që të jenë në përputhje me aftësitë mendore, shpirtërore dhe psiko-motorrike të nxënësve.

10.4. Në fund të vitit mësimor, çdo mësimdhënës është i obliguar t`a vlerësojë në mënyrë objektive shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

10.4.1. Shkëqyeshëm [arritje shumë e lartë mbi 90% - nota (5)];
10.4.2. Shumë mirë [arritje e lartë (80% - 90%) – nota (4)];
10.4.3. Mirë [arritje mesatare (60% - 80%) - nota (3)];
10.4.4. Mjaftueshëm [arritje e kufizuar (40% - 60%) - nota (2)];
10.4.5. Pamjaftueshëm [arritje e pamjaftueshme nën 40% – nota (1)].

10.5. Secili mësimdhënës duhet ta arsyetojë marrjen e vendimit (me fjalë) për notën përfundimtare të dhënë në hapësirën e veçantë në ditarin e punës në klasë.

10.6. Nxënësi duhet të vlerësohet gjatë tërë vitit shkollor për secilin lëndë mësimore apo modul mësimor të vijuar gjatë vitit shkollor.

10.7. Nëse nxënësi për shkaqe të ndryshme (me arsye) nuk i ka ndjekur 1/3 e orëve të të mësimit të parapara sipas programit të lëndës /ve dhe nuk mund të notohet në një lëndë apo grup lëndësh, drejtoria e shkollës obligohet që të ia sigurojë hyrjen në provimin klasor në fund të semestrit apo në fund të vitit mësimor, në të kundërtën humb të drejtën për notim.

10.8. Secili mësimdhënës duhet ta dijë se vlerësimi i shkallës së arritshmërisë varet drejtpërdrejtë nga standardet e arritshmërisë, të cilat janë të vendosura në planprogramin kombëtar të lëndës dhe standardet e arritshmërisë së shkollës. (10.3.).

10.9. Secila shkollë (drejtori apo personi i autorizuar) është i obliguar që në fund të klasës apo pas mbarimit të modulit, nxënësin t`a pajisë me një dokument zyrtar për kryerjen e klasës dhe shkallën e arritshmërisë.

10.10. Në arsimin fillor, klasa 1 deri 5 nxënësi nuk mund të shpallet përsëritës por përcillet në klasën vijuese.

10.11. Në arsimin e mesëm të ulët, nëse nxënësi në fund të vitit mësimor ka në katër e më shumë lëndë, arritje të pamjaftueshme nën 40% – notën (1), shpallët përsëritës i klasës.

10.12. Nëse nxënësi i arsimit të mesëm të ulët në fund të vitit mësimor ka një, dy apo tri lëndë, arritje të pamjaftueshme nën 40% – notën (1) duhët që brenda tre afateve të catuara kohore (Qershor, Gusht dhe Tetor) t`i nënshtrohet riprovimeve nga ato lëndë dhe duhet të arrijë njërën nga shkallet e arritshmërisë, të cekur në 10.4.1.deri 10.4.4; në të kundërtën shpallet përsëritës i klasës.

10.13. Në arsimin e mesëm të lartë nëse nxënësi në fund të vitit mësimor ka në tri e më shumë lëndë, arritje të pamjaftueshme nën 40% – notën (1), shpallët përsëritës i klasës.

10.14. Nëse nxënësi i arsimit të mesëm të lartë në fund të vitit mësimor ka një apo dy lëndë, arritje të pamjaftueshme nën 40% – notën (1) duhët që brenda dy afateve të catuara kohore (Qershor dhe Gusht) t`i nënshtrohet riprovimeve nga ato lëndë dhe duhet të arrijë njërën nga shkallet e arritshmërisë, të cekur në 10.4.1. deri 10.4.4; në të kundërtën shpallet përsëritës i klasës.

Neni 11
Kriteret e vlerësimit sipas aftësive në nxënie

11.1. Mësimdhënësi vlerëson me notën (5) (arritje shumë e lartë 90%) nxënësin i cili zotëron:

11.1.1. Aftësi shumë të lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.

11.1.2. Aftësi shumë të lartë të të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave, të gjykuarit e thjeshtë.

11.1.3. Aftësi shumë të lartë të të menduarit kritik në situata komplekse si : njohja e informacioneve relevante, zgjidhja e problemeve duke i zbatuar parimet ushtrimet e intrepretueshme etj.

11.2. Mësimdhënsi vlerëson me notën (4) (arritje e lartë 80%) nxënësin i cili zotëron:

11.2.1. Aftësi të lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.

11.2.2. Aftësi të lartë të të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave, të gjykuarit e thjeshtë.

11.2.3. Aftësi të lartë të të menduarit kritik në situata komplekse si : Njohja me informatat relevante, zgjidhja e problemeve duke i zbatuar parimet dhe ushtrimet e intrepretueshme.

11.3. Mësimëdhënsi vlerëson me notën (3) (arritje e kënaqshme 60%) nxënësin i cili zotëron:

11.3.1. Aftësi mesatare në njohje dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.

11.3.2. Aftësi të kënaqshme të të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave të gjykuarit e thjeshtë.

11.3.3. Aftësi të kufizuar të të menduarit në situata komplekse : si njohja me informatave relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe dhe ushtrimet e interpretueshme etj.

11.4. Mësimëdhënësi vlerëson me notën (2) (arritje e kufizuar 40%) nxënësin i cili zotëron:

11.4.1. Aftësi të kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.

11.4.2. Aftësi të kufizuar të të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore.

11.5. Mësimdhënësi vlerëson me notën (1)(arritje pamjaftueshme) nxënësin i cili zotëron:

11.5.1. Aftësi jo të mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.

11.5.2. Aftësi të pamjaftueshme të të kuptuarit dhe të detyrave dhe të proceseve shkencore.

11.6. Mësimi zgjedhor, pas aprovimit nga organet profesionale të shkollës, e ka

statuesin e mësimit të rregullt, me të vetmin përjashtim që mësimi zgjedhor vlerësohet me notë përshkruese: arritje shumë e lartë, arritje e lartë, arritje e kënaqshme, arritje e kufizuar që realizohet sipas Nenit 11. (11.1-11.4.) Kriteret e vlerësimit sipas aftësive në nxënie.

11.7. Në çdo shkollë ku është paraparë që të mbahet Praktika Profesionale sipas drejtimit të shkollës dhe përmbajtjeve progaramore të fushave lëndore; Drejtori me Këshillin e shkollës mbështetur në këtë Udhëzimin Administrativ është i obliguar që të përgatitë një rregullore për: Procedurën, Përmbajtjen programore dhe Vlerësimin e Praktikës Profesionale.

11.7.1. Vlerësimi i nxënësve në Praktikë Profesionale bëhet sipas këtyre kritereve themelore:

A. Aftësitë

a. Aftësitë e njohjes së përmbajtjes vëllimore të punës dhe mjeteve të punës si dhe rolit të tyre.
b. Aftësitë e të kuptuarit të përmbajtjes programore të punës dhe mjeteve të punës .
c. Aftësitë e zbatimit të teorisë në praktikë dhe shfrytëzimi i mjeteve të punës.
d. Aftësitë e të menduarit kritikë dhe kreativ për procesin e punës.
e. Aftësitë e komunikimit dhe integrimit shoqëror : aktivizimi brenda grupit, mirëkuptim, tolerancë, solidaritetit, korrektësisë, vetëpërmbajta, paanshmëri, kompromis, bashkëpunues etj.

B. Shkathtësitë

Virtyti profesional dhe cilësia individuale që shprehin qëndrime dhe vlera ndaj punës si: shkathtësia, kualiteti, pedantëria, përpikëria, siguria, përgjegjësia, ndjenja e detyrës, zelli, rregulli, iniciativa, efikasiteti, preciziteti, durimi, motivimi, interesimi, shpejtësia, jo improvizimi pa leje, kujdesi, respektimi i rregullave, saktësia dhe kualiteti i kryerjes së punës.

11.7.2. Bazuar në kompetencë, kriteret e realizimit vlerësohen si: arritje shumë e lartë, arritje e lartë, arritje e kënaqshme, arritje e kufizuar dhe jo e arritur; që realizohet sipas Nenit 11. Kriteret e vlerësimit sipas aftësive në nxënie.

Neni 12
Përshkrimi dhe përfundimi i notës

12.1. Pas çdo vlerësimi, nota vendoset në rubrikën përkatëse të emrave ose në ndonjë dokument tjetër në vendin, ku është paraparë të vendoset nota.

12.2. Notën mësimdhënësi mund ta vë në notesin e vet por gjithsesi e vendos në ditar apo dokument me vlerë numerike (1-5). Nota vendoset haptas dhe nxënësi njoftohet për notën e merituar.

12.3. Nëse brenda një ore, gjatë vlerësimit në klasë me ndonjë mjet të matjes, (Testi me gojë, Testi me shkrim etj.) mësimëdhënësi konstaton se 60% e nxënësve, nuk e zotërojnë përmbajtjen e caktuar programore atëherë mësimëdhënësi e ndërpren, vlerësimin dhe shpallë të pavlefshëm vlerësimin dhe duhet t`i gjej shkaqet dhe të ripunojë përmbajtjen e caktuar programore.

12.4. Brenda një semestri (gjysmëvjetori) nxënësi duhet të ketë së paku: dy nota në lëndët që kanë 2 orë në javë, tri nota për lëndët që kanë 3 orë në javë, katër nota për lëndë që kanë 4 e më shumë orë në javë **.**

12.5. Notën përfundimtare e vendosë mësimdhënësi në praninë e nxënësve të klasës në fund të vitit mësimor.

12.5.1. Nota përfundimtare në fund të vitit mësimor nuk është e domosdoshme të jetë mesi arifmetik i suksesit, kryesisht avansohet përparimi i nxënësit.

12.5.2. Suksesi i përgjithshëm i nxënësit nxirret si mes aritmetik i rrumbullaksuar me numër të plotë, (p.sh. 2.50 - 3.49 përfundohet e rrumbullaksuar 4, etj.).

12.6. Shkalla e arritshmërisë në fund të gjysmëvjetorit të parë shfrytëzohet për të analizuar dhe kontrolluar punën e mësimdhënësit dhe të nxënësit në klasë dhe për të marrë masat e nevojshme për arritjen e objektivave të përcaktuara paraprakisht.

12.7. Për notën e vendosur në dokument duhët të pajtohet edhe nxënësi.

12.8. Nëse nxënësi nuk pajtohet me vlerësimin e mësimdhënësit, ai ka të drejtë të ankohet fillimisht te mësimdhënësi kujdestar, e pastaj në këshill të klasës, dhe këshill të arsimtarve (brenda 48 orë pas komunikimit të suksesit) poqese këshilli i arsimtarve mbetet në vendimin e vlerësimit të mësimdhënsit atëherë nxënësi ka të drejtë të ankohet në Zyrën Rajonale.

12.9. Për notën që ankohet nxënësi:

12.9.1. Këshilli i klasës në pajtim me drejtorin e shkollës e cakton një komision vlerësues (i cili duhët ta vlerësoi nxënësin brenda 48 orë): me kryetar kujdestrain e klasës dhe me dy anëtarë të aktivit profesional.

12.9.2. Zyra Rajonale në bashkpunim me Drejtorin Komunale, formon komisionin (i cili duhet ta vlerësojë nxënësin brenda 48 orë): me një përfaqësues nga shkolla, kujdestari i klasës dhe dy mësimëdhënës jashtë shkollës ku nxënësit ka vijuar mësimin e lëndës në të cilën vlerësohet nxënësi.

Për çdo vlerësim me komision duhet të mbahet procesverbali.

12.10. Vlerësimin e nxënësve në riprovim e realizon komisioni: arsimtari i lëndës, kujdestari i klasës, kryetar dhe një anëtarë i aktivit profesional.

12.11. Për nxënësit jo të rregullt vlerësimi realizohet me komision, kryetarit dhe dy anëtarëve të aktivit profesional i caktuar nga këshilli i klasës me pajtimin paraprak të drejtorit të shkollës.

12.12. Notën e verifikon këshilli i klasës, suksesin e aprovon këshilli i arsimtarëve, notat përshkruhen në Librin Amë e pastaj drejtoria e shkollës lëshon dokumentin zyrtar.

Neni 13 Kriteret e vlerësimit

13.1. Kriteret e vlerësimit të objektivave të dijes sipas niveleve të shkollimit

13.1.1. Në nivelin e parë gjatë vlerësimit të përmbajtjes programore, kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave të dijes**;** njohje 40 % , të kuptuarit 30 %, të zbatuarit 20 % dhe mendim kritik 10 %.

13.1.2. Në nivelin e dytë gjatë vlerësimit të përmbajtjes programore, kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas objektivave të dijes : njohje 20 % , të kuptuarit 30 %, të zbatuarit 30 % dhe mendim kritik 20 %.

13.1.3. Në nivelin e tretë gjatë vlerësimit të përmbajtjes programore, kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave të dijes : njohje 15 % , të kuptuarit 20 %, të zbatuarit 35 % dhe mendim kritik 30 %.

13.2. Kriteret e vlerësimit të objektivave emocionale sipas niveleve të shkollimit

13.2.1. Gjatë procesit të vlerësimit në fushën emocionale, mësimdhënësi duhet të vlerëson këto shkathtësi: Qëndrimet dhe vlerat; Dobitë; Vlerësimi; Përshtatja.

13.2.2. Në nivelin e parë të shkollimit, gjatë vlerësimit, në fushën emocionale kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave**;** pranimi (ndërgjegjësim, gadishmëri, përzgjedhje, dmth të dëgjuarit dhe vëmendëshmëria) 40 % , reagimi (bindja ose përmbushja) 30 %, vlerësimi (demonstrime të parapëlqyera të caktuara, apo shfaqje e një shkalle të lartë të natyrëshmërisë dhe detyrimet) 20 % dhe përshtatja dhe organizimi (përshtatja dhe organizimi i një system vlerash e pastaj vendosja se cila prej tyre do të mbizotrojë) 10 %.

13.2.3. Në nivelin e dytë të shkollimit, gjatë vlerësimit, në fushën emocionale kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave**;** pranimi 30%, reagimi 40%, vlerësimi 20% dhe përshtatja dhe organizimi 10 %.

13.2.4. Në nivelin e tretë të shkollimit, gjatë vlerësimit, në fushën emocionale kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave**;** pranimi 20%, reagimi 30%, vlerësimi 30% dhe përshtatja dhe organizimi 20 %.

13.3. Kriteret e vlerësimit të objektivave psikomotorike sipas niveleve të shkollimit

13.3.1. Në nivelin e parë të shkollimit gjatë vlerësimit, kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave psikomotorrike**;** imitim (të vëzhgojë dhe të

përsërisë) 40% , manipulim (riprodhim i veprimeve të përzgjedhura sipas udhëzimeve të dhëna, pa ndimën e modelit pamor apo vëzhgim të drejtëpërdrejtë) 30 %, saktësi (kryerja e veprimit sa me më shumë kotrollë dhe zvoglimi në minimum i gabimeve) 20 % , artikulimi (koordinim i veprimeve kryerja e saktë e veprimeve me kontrollë, shpejtësi dhe rimë) dhe natyralizim (kryerja e veprimeve në mënyrë të natyrshme dhe pa sforcime) 10 %.

13.3.2 Në nivelin e dytë të shkollimit, gjatë vlerësimit, kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave psikomotorike**;** imitim 30% , manipulim 40 %, saktësi 20 % , artikulimi dhe natyralizim 10 %.

13.3.3. Në nivelin e tretë të shkollimit, gjatë vlerësimit, kërkesat duhen të jenë të shpërndara sipas ojektivave psikomotorike***;*** *imitim 20% , manipulim 30%, saktësi 30%, artikulimi dhe natyralizim 20 %.*

Neni 14
Metodat e vlerësimit

14.1. Secili mësimdhënës duhet të përdorë metodën e njejtë të vlerësimit me ate të mësimëdhënies.

14.2. Metodat kryesore të vlerësimit janë:

a. individuale
b. grupore
c. e kombinuar (integrative)
d. vrojtimi
e. të dëgjuarit aktiv
f. vetëvlerësimi
g. vlerësimi i brendshëm
h. vlerësimi i jashtëm

Neni 15
Vetëvlerësimi

15.1. Vlerësimi si proces i mbledhjes, analizimit, interpretimit të informatave dhe veprimtarisë që nxënësi e bënë vetë, me anë të pyetësorit i përgatitur nga mësimëdhënësi apo ndonjë mjeti tjetër vlerësues, si portfolio (dosja), është proces i vetëvlerësimit; këtë vlerësim nxënësi e realizon duke krahasuar rezultatet e veta me rezultatet e nxënësve të tjerë, apo duke i zgjedhur teknika të ndryshme të vlerësimit (shih 3.3).

15.2. Vetëvlerësimi i bazuar në kritere të drejta, krijon bazë për të motivuar përmirësuar dhe çmuar më tej arritjet në të nxënit e nxënësve.

15.3. Në procesin e vlerësimit, në mënyrë indirekte merr pjesë edhe prindi; që realizimin e bënë duke marrë informata të drejtpërdrejta nga nxënësi (fëmija), kujdestari i klasës

(përmes pytësorit për shkathtësitë e nxënësit) nga mësimdhënësit e tjerë, apo me anë të dosjes a ndonjë mjeti tjetër.

Neni 16
Vlerësimi i jashtëm

16.1. Shkalla e arritshmërisë së nxënësit matet edhe me vlerësimin e jashtëm nga ekzaminues të ndryshëm jashtë shkolle publike apo private.

16.2. Vlerësimi i jashtëm realizohet pas mbarimit të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë (klasa 5, klasa 9, klasa 12/13) nga institucioni përkatës shtetëror për vlerësim.

16.3. Vlerësimin e jashtëm mund ta realizojë MASHT, Zyra Rajonale e Arsimit apo ndonjë Agjensie e pavarur e autorizuar nga MASHT.

Neni 17
Dispozitë e veçantë e vlerësimit

17.1. Trajtimi i të vlerësuarit të nxënësve me nevoja të veçanta, me vështirësi në nxënie, me probleme emocionale të traumatizuar etj.

17.2. Trajtim i të vlerësuarit të nxënësve me talent, aftësi të veçanta dhe me shkathtësi të lartë intelektuale.

17.3. Vlerësimi i njohurive të nxënësve nga neni 15.1 dhe 15.2 bëhet në përshtatshmëri me objektivat dhe rezultatet e arritshmërisë në mësim të individualizuar.

Neni 18
Drejtori i shkollës

18.1. Drejtori i shkollës është i obliguar që në fillim të çdo viti shkollor t`i njoftojë dhe t'i siguroj një kopje të këtij udhëzimi administrativ të gjithë mësimëdhënësve.

18.2. Secili kujdestar i klasës është i obliguar që të përpilojë një listë të detyrave dhe të drejtave të nxënësit në procesin e vlerësimit që burojnë nga ky udhëzim administrativ.

18.3. Prindi ka obligim të përcjellë vijueshmërinë e nxënësit në mësim, punën dhe përparimin e tij, të ndihmojë mësimdhënësit me vështirësitë në procesin e mësimit poashtu ka të drejtë të jetë i njohtuar me gojë ose me shkrim për vijimin e rregullt të mësimit, punën, angazhimin, suksesin dhe sjelljet e fëmijëve të tij.

Neni 19
Dispozitë përfundimtare

19.1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohen të gjitha aktet paraprake juridike që kanë rregulluar këtë fushë.

19.2. Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin nga Ministri.

_____
Rexhep Osmani, Ministër

Shtojcë:

- Objektivat e përgjithshme:
  - Njohja përfaqëson nivelin më të ulët të rezultateve të të nxënit, ku nxënësi është në gjendje të riprodhojë informacionin, të njoh faketet, termonologjinë dhe rregullat.
  - Të kuptuarit është niveli më i lartë i rezultateve të të nxënit, ku nxënësi është në gjendje të ndryshojë formën e komunikimit, duke transformuar dhe riformuluar është folur apo lexuar.
  - Të zbatuarit është shkalla më e lartë e rezultatit të të nxënit. Është aftësi e nxënësit që të përdorë apo zbatojë informacionet e njohura në situata të reja të jetës së përditshme.
  - Të analizuarit është rezultat mjaft kompleks i të nxënit. Është aftësi e nxënësit që të zbërthej një informatë në pjesët përbërëse të saj dhe ti krahasojë ato me qëllim të të kuptuarit e informatës dhe nxierrjes së përfundimeve.
  - Sinteza është rezultat kompleks i të nxënit. Është aftësi e nxënësit që të bëjë bashkimin e pjesëve të ndryshme në një tërsi apo të nxjerrë përfundime logjike në bazë të informative të ndryshme relative.
  - Vlerësimi është rezultat kompleks më i lartë i të nxënit. Është aftësi e nxënësit që të gjykojë për cilësinë e informatës apo vlerën e një materjali të shkruar. Këtu gërshetohen të gjitha llojet e rezultateve të të nxënit. (Mendimi kritik përfaqëson : analizën, sintezën dhe vlerësimin).

- *Përparësia e objektivave në klasën e caktuar, në nivelin e caktuar ose në fushën e caktuar të lëndës duhen të jenë të lidhura ngushtë me parimet e të nxënit:*
  - *Të jenë të përvetësueshme nga niveli i nxënësve (parim i gatishmerisë)*
  - *Të jenë të lidhura me nevojat dhe dobitë e nxënësve (parimi i motivimit)*
  - *Të reflektojë rezultatet e të nxënit (parimi i reflektimit)*
  - *Përfshirja e rezultateve të të nxënit që janë të zbatueshme në situata të ndryshme. specifike (manovruese dhe zbatuese).*
- *Lista provuese e rezultateve udhëzuese të të nxënit relevant në procesin e vlerësimit:*
  1. ***Kompletimi;*** *a janë të përfshira të gjitha rezultatet e rëndësishme?*
  2. ***Harmonizimi;*** *a janë rezultatet e të nxënit në harmoni me qëllimet e shkollës?*
  3. ***Shkathtësia;*** *a janë rezultatet në përputhje me parimet e të nxënit?*
  4. ***Mundësia;*** *a janë rezultatet e pritura reale dhe në përputhje me aftësitë e nxënësve, mundësitë kohore dhe të institucionit?*
  5. ***Lista përfundimtare e ojektivave udhëzuese:*** *arritja e objektivave udhëzuese varet më shumë nga metoda e përpilimit të udhëzimeve se sa nga përmbajtja e udhëzimit.*